

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7880  
E martë, 10 shtator 2024  
Çmimi 0.50

KOMF-i: Arsimi,  
në rënie të lirë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## KONJUFCA: BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE PO TREGOHET E NJËANSHME NË RAPORTET ME KOSOVËN DHE SERBINË | FAQE 4-5



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të hënën se bashkësia ndërkombëtare po tregohet e njëanshme kur bëhet fjalë për raportet e saj me Kosovën dhe me Serbinë. "Ne jemi të

vetëdijshëm dhe kjo është e qartë që bashkësia ndërkombëtare është e njëanshme në relacionet në mes të Kosovës dhe Serbisë, për këtë arsye besoj se duhet drejtim krejt i ri", ka thënë

Konjufca të hënën në një konferencë për medie, duke theksuar se nuk pret diçka as nga raundi i ardhshëm i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel kryenegociatorësh

### OPINION

NJË POLITIKË QË NUK  
MERITON TË FITOJË | F. 7

Shkruan: Faton  
ABDULLAHU



### AKTUALE



FOKUSI I VON DER LEYENIT TE  
ZGJERIMI: 2030 MUND TË JETË  
AFAT REAL | F. 2

KURTI TAKON UDHËHEQJEN E  
KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT, DISKU-  
TOJNË PËR QEVERISJEN KOMUNALE  
NË 15 MUAJT E FUNDIT | F. 5

### EKONOMI

"TREPÇA" KA KRIZË TË PRODHIMIT | F. 8

LATIFI: FESTA E VJELJES SË  
RRUSHIT 'HARDH FEST 2024' ISHTE  
NJË ATMOSFERË E PËRSOSUR | F. 8

### SPORT



FITORJA QË NGRIT MORAL:  
KOSOVA TRIUMFON ME 4:0 NDAJ  
QIPROS NË NDESHJEN E LIGËS  
SË KOMBEVE | F. 10

HARADINAJ GODET  
OSMANIN: NË ÇDO  
NDYRËSIRË TË  
KURTIT, TI JE NË  
MES TË SAJ | F. 7



KUVENDI NIS  
SESIONIN  
VJESHTOR,  
OPOZITA DREJTON  
KRITIKA PËR  
QEVERINË KURTI | F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Fokusi i Von der Leyenit te zgjerimi: 2030 mund të jetë afat real



PRISHTINË, 9 SHTATOR - Presidentja e rizgjedhur e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka paralajmëruar se në ekipin e saj të ri me mandat pesëvjeçar do të ketë një komisionar për zgjerim. Ajo e ka thënë këtë për të treguar se procesi të zgjerimit do t'i kushtohet rëndësi dhe kujdes i veçantë.

Edhe në përbërjet e deritashme të Komisionit Evropian ka pasur komisionar për zgjerim, por ai ka qenë përgjegjës edhe për politikën fqinjësore të BE-së. Me zgjerimin është marrë vetëm pjesërisht, pasi në resorin e tij ka pasur përgjegjësi edhe për vendet në fqinjësi të BE-së - nga lindja e Evropës deri te vendet e Afrikës së Veriut. Hera e fundit kur Komisioni Evropian ka pasur komisionar vetëm për zgjerim ka qenë gjatë mandatit të parë të Komisionit Evropian të udhëhequr nga Jose Manuel Barroso, nga viti 2004 deri në vitin 2009. Atëkohë këtë rol e ka pasur komisionari Olli Rehn. Më pas, për

tri mandate radhazi të Komisionit, komisionari për zgjerim ka qenë i angazhuar edhe me politikën ndaj fqinjëve.

Drejtorja për Zgjerim është shndërruar, po ashtu, në Drejtori të Përgjithshme për Fqinjësi dhe Zgjerim. Shkurtesë e saj ishte NEAR, që nga anglishtja i bie 'afër'. Kjo është shpjeguar me faktin se vetëm disa vende kanë qenë në procesin e zgjerimit dhe shumica prej tyre në fazën fillestare.

Tash, me përfshirjen e tri vendeve të Evropës Lindore në procesin e zgjerimit - Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë - krahas gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor - Malit të Zi, Serbisë, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës - si dhe Turqisë - numri i vendeve në procesin e zgjerimit është rritur në dhjetë. Të gjitha, me përjashtim të Kosovës, kanë edhe formalisht statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim

në këtë bllok qysh në dhjetor të vitit 2022, por kërkesa e saj deri më tash nuk është shqyrtuar.

Në BE, ndërkohë, është rritur mbështetja për procesin e zgjerimit dhe pritet që ai të përshpejtohet. Presidenti në largim i Këshillit Evropian, Charles Michel, e ka përmendur vitin 2030 si afat deri kur edhe BE-ja, edhe vendet candidate do të duhej të bëheshin gati për zgjerim.

Edhe udhëheqës të tjerë të BE-së kanë bërë thirrje që të dyja palët, si vendet candidate, ashtu edhe Bashkimi Evropian, ta kryejnë pjesën e tyre të punës, për të mundësuar realizimin e qëllimit të procesit të zgjerimit, përkatësisht pranimin formal të vendeve candidate në BE.

Mali i Zi, si vend që ka avancuar më së shumti në procesin e negociatave të anëtarësimit, është edhe më ambicioz.

Presidenti i tij, Jakov Millatović, ka shprehur bindjen se Mali i Zi do të mund të bëhet anëtar i BE-së deri

në vitin 2028.

Megjithatë, në BE thonë se nuk mund të caktohet data se kur dhe cili vend mund të anëtarësohet, sepse kjo varet nga meritat individuale të kandidatëve dhe rezultatet e tyre në përbushjen e kriterëve të anëtarësimit.

Diplomatët në BE pranojnë se, nëse ka vullnet politik nga të dyja anët, atëherë edhe afatet kohore - sidomos viti 2030 - për të pranuar anëtarë të rinj në BE, mund të jenë reale.

Vendet candidate duhet të përshpejtojnë në procesin e reformave, ndërsa vendet e BE-së duhet të pajtohen për hapjen dhe mbylljen më të shpejtë të kapitujve përkatës në procesin e negociatave të anëtarësimit.

Von der Leyen është zotuar se do ta ketë prioritet zgjerimin por, siç pohon zëdhënësja e BE-së për zgjerim, Ana Pisonero, ajo edhe deri më tash e ka pasur këtë proces ndër prioritetet e saj. "Zgjerimi i BE-së ishte prioritet gjatë mandatit të parë

të presidentes von der Leyen. Ajo ka bërë me dije se edhe në të ardhmen do ta ketë prioritet strategjik, duke avancuar qëllimin e saj që në përbërjen e ardhshme të kolegjit të ketë një komisionar për zgjerim", thotë Pisonero për Radion Evropa e Lirë.

Edhe Jana Jurova, eksperte për zgjerim nga Instituti për Politikën Evropiane, EUROPEUM, mendon se tash ka vërtet vullnet politik për të pranuar anëtarë të rinj në bllok. "Besoj se kemi një vullnet të caktuar politik brenda BE-së se duhet dhënë prioritet zgjerimit. Këtë vullnet nuk e kemi parë në dekadën e fundit. Nëse një vend kandidat dëshmon progres bindës në përbushjen e kriterëve të anëtarësimit, është e mundshme që të shohim zgjerim deri në vitin 2030, apo së paku përmbyllet negociatave të anëtarësimit dhe nisjen e procesit të ratifikimit të Traktatit të Anëtarësimit", thotë Jurova për Radion Evropa e Lirë.

Diplomatët në Bruksel pranojnë se edhe BE-ja, edhe rajoni i Ballkanit Perëndimor, por edhe Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia kanë nevojë për dëshmi konkrete se zgjerimi i BE-së është real dhe i mundshëm. Dhe kjo, siç thonë, mund të dëshmohet më së miri përmes pranimit të ndonjë vendi të ri anëtar.

Prej vitesh, përveç përmendjes së zgjerimit si prioritet, nuk ka pasur ndonjë rezultat të dukshëm në këtë proces. Vendi i fundit që është anëtarësuar në BE ka qenë Kroacia në vitin 2013.

Që prej themelimit të Bashkimit Evropian nuk ka ndodhur që të kalojnë qat shumë vite pa pasur zgjerim. Për më tepër, BE-ja ndërkohë është tkurrur nga 28 anëtare në 27, pasi Britania e Madhe ka dalë prej saj.

Tani, përkundër gatishmërisë së Komisionit Evropian për zgjerim, fati i këtij procesi varet nga vendet anëtare, pasi vendimet në Këshill miratohen me pajtimin e të 27 vendeve.

## Kina dhe Rusia, stërvitje të përbashkëta ushtarake

PEKIN, 9 SHTATOR - Ministria kineze e Mbrojtjes njoftoi se gjatë këtij muaji do të mbajë stërvitje detare dhe ajrore me Rusinë, duke nënvizuar afërsinë mes dy ushtrive, teksa Rusia po vazhdon pushtimin e Ukrainës fqinje.

Ministria tha se stërvitjet "Veri i Bashkuar - 2024" do të mbahen në Detin e Japonisë dhe në Detin e Okotskit, por nuk dha më shumë detaje.

Në njoftim u tha se stërvitjet detare dhe ajrore synojnë ta

përmirësojnë bashkëpunimin strategjik mes dy shteteve dhe "forcimin e aftësive që së bashku të përballen me kërcënimet e sigurisë".

Ministria kineze tha se dy marinat do të lundrojnë së bashku në Paqësor, për herë të pestë, dhe së bashku do të marrin pjesë në stërvitjet "Oqeani i Madh-24" që do të mbahet në Rusi. Por, as për këto stërvitje nuk u dhanë detaje të tjera.

Kina ka refuzuar ta kritikojë

pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia. Për këtë luftë, që është në vitin e tretë, Pekini ka fajësuar Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n për provokim të presidentit rus Vladimir Putin.

Përderisa Kina nuk i ka ofruar në mënyrë të drejtpërdrejtë armë Rusisë, Pekini është shndërruar në konsumatorin kryesor të gazit dhe naftës ruse, por edhe furnizues i mjeteve elektronike dhe pajisjeve të tjera që kanë përdorime civile dhe ushtarake.





# KOMF-i: Arsimi, në rënie të lirë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 9 SHTATOR** - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF ka mbajtur konferencë për medie dedikuar arsimit në Kosovë: "Arsimi në rënie të lirë".

Paneli i përbërë nga anëtarët e KOMF-it: Remzije Krasniqi, presidente e KOMF-it, Lulavere Behluli, Eldin Gashi dhe Marija Vuksani adresuan qëndrimet për gjendjen e arsimit në Kosovë, duke u fokusuar në aspektet e cilësisë në arsim, mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, gjithëpërfshirjes, parandalimit të braktisjes, si dhe risive e sfidave të modelit të mësimin tërëditor.

Në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë janë të regjistruar gjithsej 314 006 nxënës. Ky sistem mbështetet nga një personel arsimor prej 27 710 individësh, nga të cilët 22 836 janë mësimdhënës/e. Numri i institucioneve edukative-arsimore publike në vend është 1 036.

Sipas këtij paneli, arsimit parauniversitar në Kosovë përballet me sfida dhe probleme të shumta që ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit.

Kalueshmëria në Testin e Arritshmërisë për këtë vit është vetëm 52.1 %.

Sipas raportit monitorues të KOMF-it "Karta e vlerësimit", puna e institucioneve publike arsimore në Kosovë është vlerësuar me notën 2.5 në një shkallë nga 1 deri në 5. Për më tepër, Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve e renditi Kosovën në vendin e 76 nga 80 shtete, duke treguar një nivel të ulët të cilësisë në arsim. Faktorët që kontribuojnë në cilësinë e ulët të arsimit në Kosovë përfshijnë: planprogrami i mbingarkuar; cilësia e mësimdhënies; numri tejet i madh i nxënësve në klasa, sidomos në qytete; shkollat, klasat me numër shumë të vogël të nxënësve, duke përfshirë edhe klasat e kombinuara në vendet rurale; qëndrimi për kohë të shkurtër në shkolla; mungesa e infrastrukturës adekuate; mungesa e aktiviteteve ekstra kurrikulare; menaxhimi jo i mirë i shkollave; politizimi i kuadrove arsimorë; mungesa e bashkëpunimit ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve; llogaridhënia e ulët dhe ndërprerjet e shumta të procesit mësimor (përfshirë ndërprerjet për shkak të

grevave në arsim).

Duke iu referuar raportit monitorues të KOMF-it "Karta e vlerësimit", krahas cilësisë së ulët në arsim, shkollat publike në Kosovë përballen edhe me vështirësi të tjera sikurse dhuna në shkolla dhe gjithëpërfshirja e ulët. "Shkollat publike në Kosovë nuk e plotësojnë në plotni konceptin e shkollave mike për fëmijë, kjo për shkak të mjedisit të pasigurt dhe jo miqësor, infrastrukturës së papërshtatshme, qasjes së mësimdhënësve, mungesës së personelit profesional pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, mungesës së bashkëpunimit të mirëfilltë me prindër, etj. Sipas Policisë së Kosovës, ka pasur rritje të madhe të incidenteve të dhunës në shkolla, krahasuar me vitet paraprake. Gjatë vitit 2022 janë raportuar gjithsej 592 raste të incidenteve në shkolla dhe përreth tyre (në diametër shumë të afërt të institucioneve shkollore). Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, është duke u zbatuar pjesërisht. Kjo dëshmohej edhe nga numri shumë i vogël i rasteve të dhunës të raportuara në Sistemin e Menaxhimit të

Informatave në Arsim - SMIA, ku në vitin shkollor 2022/23 janë raportuar vetëm 44 raste", ka njoftuar KOMF-i, duke shtuar se edhe pse po bëhen përpjekje të vazhdueshme për ta realizuar konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, ky proces has në shumë vështirësi pasi Kosova është ende në fazën e krijimit të kulturës dhe praktikës gjithëpërfshirëse, gjë që kërkon burime njerëzore dhe fonde të mjaftueshme. "Hapa të rëndësishëm janë bërë në avancimin e politikave, duke tentuar përfshirjen e konceptit të gjithëpërfshirjes si pjesë integrale e të gjitha politikave arsimore. Megjithatë, zbatimi i këtyre politikave dhe zhvillimi i mekanizmave që sigurojnë gjithëpërfshirjen mbetet një sfida e madhe. Vetëm 3,965 fëmijë me aftësi të kufizuara janë të përfshirë në klasat e rregullta. Vetëm 609 shkolla kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla është e ulët dhe mësimdhënia nuk bazohet në nevojat individuale të fëmijëve. Gjithëpërfshirjen e vështirëson edhe më shumë mungesa e stafit profesional dhe mbështetës si asistentët për

fëmijë me aftësi të kufizuara. Sfida të tjera për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës konsiderohen:

trajnimi joadekuat i mësimdhënësve, mungesa e metodave të mësimdhënies gjithëpërfshirëse, mungesa e pajisjeve mbështetëse teknologjike/asistuese, normat dhe paragjykimet, kurrikula dhe faktorët socio-ekonomik", ka theksuar KOMF-i.

Sipas këtij raporti, shkollat publike kanë mungesë të stafit profesional dhe mbështetës sikurse psikologë dhe pedagogë. "Aktualisht në shkolla publike në nivel vendi janë rreth 200 psikologë dhe pedagogë. Marrë parasysh numrin e institucioneve arsimore prej 1,047 konsistohet se as çereku i shkollave nuk kanë psikologë/e të punësuar. Në të shumtën e rasteve, një psikolog mbulon katër shkolla. Përderisa ka komuna që nuk kanë fare psikologë të punësuar në shkolla", thuhet në këtë raport.

KOMF-i ka dhënë disa rekomandime në raport me këtë gjendje. Të investohet në ngritjen e cilësisë së arsimit, të bëhet krijimi i shkollave mike për fëmijë dhe të rritet gjithëpërfshirja në arsim.


## 30-vjeçarja përpin një gjilpërë, shpëtohet nga ekipi i Pulmologjisë

**PRISHTINË, 9 SHTATOR** - Një 30-vjeçare ka rrezikuar seriozisht shëndetin pasi që aksidentalisht kishte aspiruar një trup të huaj (gjilpërë). Gjilpëra ka

depërtuar në rrugët e frymëmarrjes, duke rrezikuar shëndetin e saj dhe duke shkaktuar shumë vështirësi për frymëmarrje. Me të parë gjendjen e

pacientes, ekipi kujdestar i Klinikës së Pulmologjisë është mobilizuar dhe përmes aparaturës së bronkoskopisë ka arritur të largojë gjilpërën që kishte

shkaktuar vështirësi dhe pengesa në frymëmarrje. Ekipi i mjekëve nga Klinika e Pulmologjisë u bënë thirrje qytetarëve të jenë të kujdesshëm.





## Konjufca: Bashkësia ndërkombëtare po tregohet e njëanshme në raportet me Kosovën dhe Serbinë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të hënën se bashkësia ndërkombëtare po tregohet e njëanshme kur bëhet fjalë për raportet e saj me Kosovën dhe me Serbinë. “Ne jemi të vetëdijshëm dhe kjo është e qartë që bashkësia ndërkombëtare është e njëanshme në relacionet në mes të Kosovës dhe Serbisë, për këtë arsye besoj se duhet drejtim krejt i ri”, ka thënë Konjufca të hënën në një konferencë për medie, duke theksuar se nuk pret diçka as nga raundi i ardhshëm i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel kryenegociatorësh

**EPOKA ERE** Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 9 SHTATOR** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të hënën se bashkësia ndërkombëtare po tregohet e njëanshme kur bëhet fjalë për raportet e saj me Kosovën dhe me Serbinë, dhe se duhet të jetë më e përcaktuar se çfarë dëshiron prej dy vendeve.

Ai ka thënë se nuk pret diçka as nga raundi i ardhshëm i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel kryenegociatorësh, që është paralajmëruar të mbahet, edhe as në drejtim të kërkesave që i janë bërë Kosovës për heqje të masave ndaj qarkullimit të mallrave serbe. “Dialogu, në formatin qysh ka qenë prej vitit 2011, e ka pasur arkivolin më 24 shtator të vitit të kaluar, me sulmin terrorist në

Banjskë, sepse informatat të cilat i ka edhe bashkësia ndërkombëtare, edhe institucionet tona të sigurisë, tregojnë qartë se ky grup i madh kriminal e ka pasur mbështetjen e drejtpërdrejtë prej shtetit serb”, ka thënë Konjufca në një konferencë për medie.

Ai ka thënë se bashkësia ndërkombëtare po tregohet e rezervuar për ta ndëshkuar Serbinë ndonëse, sipas tij, ka informacione se shteti serb qëndron pas sulmit të Banjskës. “Ne jemi të vetëdijshëm dhe kjo është e qartë që bashkësia ndërkombëtare është e njëanshme në relacionet në mes të Kosovës dhe Serbisë, për këtë arsye besoj se duhet drejtim krejt i ri”, ka thënë Konjufca, duke iu referuar dialogut në Bruksel që ndërmjetësohet nga blloku

evropian.

Më 24 shtator të vitit të kaluar një grup i armatosur serb e ka sulmuar Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke lënë të vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Në këmbim e sipër të zjarrit janë vrarë tre sulmues serbë. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - Millan Radoičiq, i cili besohet se është i lirë në Serbi.

Kosova fajëson direkt shtetin serb për organizim dhe kryerje të sulmit.

Hetime për sulmin janë duke kryer edhe Kosova edhe Serbia, por ende nuk kanë paraqitur ndonjë aktakuzë.

Konjufca ka thënë se as Kosova dhe as faktori ndërkombëtar nuk mund të publikojnë të dhëna të

detajuara nga hetimet për sulmin për shkak të ndjeshmërisë së rastit.

Konjufca i ka komentuar edhe raportimet se i dërguari i Gjermanisë për Ballkanin, Manuel Sarrazin, ka kërkuar të hiqen masat e sigurisë së Kosovës ndaj mallrave serbe.

Qeveria e Kosovës e ka ndaluar importin e mallrave nga Serbia më 15 qershor të vitit të kaluar, një ditë pasi forcat serbe patën arrestuar tre policë të Kosovës.

Mediet lokale në Kosovë kanë raportuar që Kosovës mund t'i rrezikohet anëtarësimi në Procesin e Berlinit nëse nuk merr hapa në këtë drejtim.

Procesi i Berlinit nuk është një proces formal i politikës së BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Është një nismë e Gjermanisë, e mbështetur nga vendet e tjera të BE-së si Austria, Sllovenia, Kroacia e pastaj edhe Franca, Italia, Polonia dhe të tjera, që ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e rajonit, bashkëpunimin e ndërsjellë mes tyre, ta sigurojë tërheqjen e investimeve dhe në këtë mënyrë t'i ndihmojë ato vende në përgatitjen e tyre për anëtarësim në BE në të ardhmen. “Nuk më duket që Procesi i Berlinit mund të reduktohet në

CEFTA”, ka thënë Konjufca, duke bërë thirrje që të bëhen dallime mes çështjeve ekonomike dhe çështjeve të sigurisë. “Ato që tha Sarrazin në vizitën e tij në Kosovë janë një lloj modusi i lehtëimit të Serbisë. Nëse do të keni rajon funksional, ne e dimë cila është rruga. Rruga është barazia e Kosovës me Serbinë si shtete të pavarura, që marrin pjesë në këto marrëveshje rajonale”.

Ai ka thënë se nuk pret heqje të masave të Kosovës në mallrat serbe, sidomos jo deri pas mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë, të caktuara për shkurt të vitit të ardhshëm.

Kosova është anëtare e CEFTA-s që prej vitit 2007 dhe përfaqësohet përmes Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), por autoritetet e Kosovës tani kërkojnë të përfaqësohen si shtet dhe jo përmes misionit të OKB-së. Shtete të tjera anëtare të CEFTA-s janë Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia. Në vitin 2006 këto gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar marrëveshje me qëllim të eliminimit të detyrimeve doganore dhe pengesave të tjera për tregtinë e ndërsjellë.



# Kuvendi nis sesionin vjeshtor, opozita drejton kritika për qeverinë Kurti

EPOKA  
ERE

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Në drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e parë për sesionin vjeshtor, duke shënuar kështu hapjen e punimeve të Kuvendit pas pushimeve.

Duke uruar për fillimin e punës në këtë sesion, kryetari Konjufca njoftoi Kryesinë lidhur me procesin e instalimit të pajisjeve të reja elektronike në sallën e mbledhjeve plenare.

Zëvendësuesi i sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit, Arben Loshi, bëri me dije se puna për instalimin e këtyre pajisjeve ka përfunduar më 23 gusht 2024, është bërë testimi i tyre dhe se tani sala e mbledhjeve plenare është e gatshme për përdorim.

Kryesia vendosi që seanca plenare e radhës, përkatësisht seanca e parë për këtë sesion, të mbahet të enjten, më 12 shtator, me një varg pikash, përfshirë edhe ato të bartura nga sesioni pranveror.

Në këtë mbledhje Kryesia miratoi logon e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2025, në bazë të Qarkores së Parë Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfere 2025/01,

Po ashtu, konform përgjegjësiave të saj kushtetuese, Kryesia shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Kuvendit.

Pas kësaj mbledhjeje shefat e grupeve parlamentare të opozitës drejtuan akuza në drejtim të qeverisë për mospunë.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se çka nuk është arritur të bëhet për tri vjet e gjysmë, nuk mund të arrihet të bëhet për tre muaj e gjysmë të këtij mandati. "Prandaj, i gjithë fokusi ynë në periudhën në vazhdim do të mbetet angazhimi për t'i mundësuar vendit një qeveri të re të udhëhequr nga kryeministri i ardhshëm Bedri Hamza", ka thënë ai.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se kjo legjislaturë me këtë qeveri dhe qeverisje mund të konsiderohet si qeverisja më e dobët në historinë e Kosovës si në aspektin e vendimmarrjes, të ndërtimit të konsensusit politik dhe në aspektin e përfaqësimit të institucioneve të Kosovës. "Është karakterizuar me një tendencë të kapjes së institucioneve të Kosovës, pastaj me shkelje të vazhdueshme dhe të përsëritura të Kushtetutës nga ana e qeverisë, si dhe me tendencë të vazhdueshme për paaftësimin e vendimmarrjes së Kuvendit në aspektin e mbikëqyrjes parlamentare. Pra mund të themi se në aspektin e fushëveprimtarisë së vet, si rezultat i dominimit nga Lëvizja Vetëvendosje dhe angazhimit të qeverisë së Albin Kurtit, të gjitha shtyllat e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë paaftësuar në funksionin e tyre", ka thënë Gashi.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se qeverisja katërvjeçare e Kurtit ka dëmtuar vendin si në rrafshin e brendshëm, po ashtu edhe të jashtëm. "Sa iu përket marrëveshjeve ndërkombëtare, ato kurrë nuk kanë qenë



problem, por menaxhimi i brendshëm i Kosovës, duke e kthyer prapa vendin në secilën sferë të jetës dhe duke e sjellë në stadin më të ulët qeverisës, zhvillimor dhe ndërkombëtar. Në këta muaj që kanë mbetur për Kuvendin e Kosovës, AAK-ja do të përpiqet t'i adresojë tri çështje të rëndësishme: Do ta vazhdojmë angazhimin që ta shtyjme përpara konceptin e Ligjit të Pagave, ku vlera mesatare e pagave në këtë ligj do të jetë 1 000 euro; Do ta shtyjme përpara miratimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore, i cili tash e katër vjet është në sirtar të kësaj qeverie; dhe forcimin e ekonomisë së Kosovës", ka thënë ai.

Tahiri ka thënë se Kosova kurrë nuk ka qenë më e dobët që nga shpallja e pavarësisë së saj. "Qytetarët e Kosovës ballafaqohen me problemet më

të mëdha jetese. Qytetarët që e kanë të garantuar shërbimin nga shteti i Kosovës po u mungon. Kushdo që ballafaqohet me QKUK-në, ballafaqohet me vdekjen, jo për shkak të personelit, por për shkak të kushteve dhe menaxhimit të dobët. Kushdo që ballafaqohet me mundësinë për punësim, së pari pyetet 'a je me LV-në'. Pra, pa qenë me LV-në nuk mund të bësh asnjë hap përpara për punësim. Mundësitë e barabarta për qytetarët e këtij vendi, kjo qeveri i ka varrosur", është shprehur Tahiri.

Ai ka shtuar se, për më keq, nëse flasim për sektorin privat, Kosova është zbratur. "Kosova sot ka 1.5 milion banorë apo 250 mijë më pak se në vitin 2011. Është kjo qeveri e cila ka ardhur në pushtet për ta kthyer shpresën, dhe është kjo qeveri e cila po e humb shpresën. Angazhimi ynë do të

jetë i fuqishëm në ballafaqimin me mbrojtjen e sovranitetit të Kosovës.

Politikat eksperimentuese që ndërlihen me menaxhimin e brendshëm e kanë sjellë Kosovën buzë armiqësisë me botën perëndimore, duke filluar nga ShBA-ja. Për katër vjet nuk kemi asnjë njohje, asnjë anëtarësim dhe, për më keq, katër vjet jeta e secilit qytetar është shtrenjtuar. Do të komunikojmë me qytetarët e Kosovës për t'u treguar se vota juaj për shpresën ishte mashtrimi më i madh në historinë e Kosovës. Kosova nuk guxon të dobësohet, por duhet të forcohet, për shkak se e kemi obligim për heronjtë dhe dëshmorët që e dhanë jetën për liri, dhe e kemi obligim për fëmijët tanë dhe të rinjtë të cilët sot po i shikojmë mundësitë për të tjera vende", ka deklaruar Tahiri.

## Kurti takon udhëheqjen e komunës së Leposaviqit, diskutojnë për qeverisjen komunale në 15 muajt e fundit

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka vazhduar takimet me kryetarët e komunave veriore të vendit dhe drejtorët komunalë. I shoqëruar nga ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashqi dhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kësaj radhe mirëpritën për mëngjes pune në kryeministri, kryetarin e komunës së Leposaviqit, Luzim Hetemi, nënkryetaren Marina Bogojeviq dhe drejtorë komunalë.

Gjatë takimit u diskutua gjerësisht mbi qeverisjen komunale në 15 muajt e fundit, shërbimet e reja, përfshirë ato që ofrohen nga agjencitë qendrore, sikurse Agjencia e Punësimit dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, dhe praktikat e mira të vendosura me udhëheqjen aktuale.

U diskutua edhe rreth sfidave të



trashëguara dhe nevojën për investime kapitale për qasje në ujë të pijshëm, ndriçim publik dhe

infrastrukturë, veçanërisht në fshatra dhe zona të thella të komunës.

Kryetari Hetemi, nënkryetarja Bogojeviq dhe drejtorët veçuan rëndësinë e dëgjimeve buxhetore

që kanë mbajtur deri më tani me qytetarë nga radhët e komunitetit serb, boshnjak dhe shqiptar, me qëllim adresimin e kërkesave të tyre dhe planifikimit të projekteve dhe përgatitjet e kërkesave për mbështetjen nga niveli qendror.

Kryeministri Kurti i falënderoi drejtuesit dhe stafin e komunës së Leposaviqit për punën dhe angazhimin e përditshëm dhe për bashkëpunimin e ngushtë me ministrinë dhe Zyrën e Kryeministrit për realizimin e projekteve në interes të komunës. Bashkë me ministrat në takim, ai i ofroi kryetarit Hetemi dhe nënkryetares Bogojeviq mbështetjen e tij dhe gatishmërinë për të punuar sa më afër për adresimin sa më të shpejtë të kërkesave të kësaj komune që burojnë nga nevojat e qytetarëve për vitin e ardhshëm buxhetor.



## Prokuroria e Prizrenit për një muaj ngre 187 aktakuza

PRIZREN, 9 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Prizren gjatë muajit gusht 2024 ka ngritur gjithsej 187 aktakuza kundër 244 personave për raste të ndryshme penale. Në Departamentin e Krimeve të Rënda janë ngritur 6 aktakuza kundër 6

personave. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie gjatë muajit gusht ka ngritur 170 aktakuza kundër 222 personave për vepra të ndryshme penale. Ndërsa nga Departamenti për të Mitur janë ngritur 11

propozime për shqiptimin e masave edukative, të diversitetit ose dënimeve, kundër 16 të miturve. Prokuroria Themelore në Prizren ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.



## Policia e rajonit të Prishtinës për një javë sekuestroi 11 armë zjarri dhe 99 armë të ftohta

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Nga zyrtarët policorë të rajonit Prishtinës gjatë javës së kaluar në lokacione të ndryshme dhe aksione të ndara janë realizuar 161 urdhëresa të gjykatës, prej tyre 41 urdhëresa për vepra penale, ndërsa të tjerat për kundërvajtje, seanca, verifikime etj. Konform urdhëresave, pas përfundimit të procedurave

policore, personat e dënuar me burgim janë dërguar për vuajtje të dënimit, ndërsa personat e dënuar me gjobë janë liruar, pasi kanë kryer obligimet e caktuara në urdhëresa. Ndërkohë që aktivitete policore janë shtrirë edhe në segmente të tjera të sigurisë. Gjatë periudhës së njëjtë janë sekuestruar 11 armë zjarri të

llojeve dhe kalibrave të ndryshëm dhe 99 armë të ftohta (thika). Ndërkaq aktivitetet policore në sferën e sigurisë në trafikun rrugor, në po të njëjtën periudhë kohore, kanë rezultuar me shqiptimin e 4 723 masave administrative me gjobë për lloje të ndryshme të kundërvajtjeve dhe shkeljeve të kodit rrugor.

## Fshatrat Boscë dhe Strelicë të Kamenicës po bëhen me trotuar



KAMENICË, 9 SHTATOR - Nën kryetarja e komunës së Kamenicës për Komunitete, Aleksandra Jovanovic, së bashku me ministrin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, kanë nënshkruar marrëveshjen për ndërtimin e trotuareve në fshatrat Boscë dhe Strelicë. Marrëveshja në fjalë arrin vlerën e 72 549

eurosh. Kryetari Rahimaj ka thënë se kjo marrëveshje i jep përgjigje një nevojë të kamotshme të banorëve të kësaj zone. "I lumtur që investimet po japin përgjigje për secilën kërkesë të secilit komunitet e po prekin të gjitha lokalitetet", është shprehur kryetari Rahimaj.

## Fshati Shillovë në Gjilan po bëhet me park

GJILAN, 9 SHTATOR - Investimet nuk kanë të ndalur në fshatrat e komunës së Gjilanit. Në fshatin Shillovë kanë nisur punimet për ndërtimin e parkut (Xhepat e Gjelbër). I pari i komunës ka parë nga afër punimet të cilat po zhvillohen aty.

Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se po punohet me intensitet të lartë në parkun e fshatit Shillovë. "Xhepat e gjelbër ishin premtimi ynë dhe po e përmbushim atë", ka theksuar Hyseni, duke treguar se punimet pritet të përfundojnë brenda muajit shtator.



## Fillojnë punimet për çerdhen e fshatit Kërpimeh në Podujevë

PODUJEVË, 9 SHTATOR - Kanë filluar punimet për rinovimin e objektit të vjetër të shkollës së fshatit

Kërpimeh, i cili po shndërrohet në çerdhe. Kontrata për realizimin e këtij projekti është nënshkruar në

fund të muajit gusht, kurse afati i përfundimit të punimeve është 90 ditë. Pas përfundimit të

punimeve ky objekt do të bëhet vend i ngrohtë dhe i rehatshëm për fëmijët e kësaj ane.





# Një politikë që nuk meriton të fitojë



Shkruan: Faton  
ABDULLAHU

VV-ja është formësua si parti politike jo duke u ballafaquar me Serbinë, por duke u ballafaquar me institucionet e Kosovës, me partitë politike shqiptare të Kosovës dhe me faktorin ndërkombëtar. Kjo karakteristikë e trashëgimisë politike e VV-së hetohet gjithanshëm e kjo mund të parafrazohet me atë të njohurën "VV nuk e dinë çka është Serbia". Ajo me Serbinë po ballafaqohet vetëm për aq kohë sa është në pushtet dhe ate përmes dialogut. Me këtë mendësi VV-ja e ka vendosur kështu Serbinë, në pozitën më të mirë në arenën ndërkombëtare në të cilën ka qenë ndonjëherë që nga përfundimi i luftës.

VV-ja gjithashtu është formësuar si parti politike ideologjikisht nga parimi bazik refuzues, që më pas, do të formulohet si slogan "Qe 20 vite e keni shkatërruar këtë vend" Kjo moto ka njësur parimet dhe metodat përjashtuese, jo në institucione por rrugeve me protesta, shpesh të dhunshme e disa herë edhe me viktima e shumë herë me përleshje me hudhje gurësh, gazit, etj. Ky parim i VV-së ka qenë barometër moral-politik dhe

njësi matëse e përshtatshmërisë ideologjike që ka determinuar vlerësimet dhe raportet me gjithë të tjerët në Kosovë dhe jashtë saj.

Nga këto dy shtylla bazike, VV-formësimet politiko-kulturore, përjashtuese dhe refuzues, kanë detrimuar edhe disa karakteristika të tjera të cilat e kanë stërkequr ate deri në deformime regresive.

E para - Duke mohuar çdo të arritur për 20 vite, kanë pohuar se institucionet janë të kapura dhe duhet të ç'kapen me politikat e VV-së.

Duke i kualifikuar institucionet e Kosovës si të kapura keq, shumë dhe për kohë të gjatë, VV-ja ka preferuar me bindje të plotë ta ngrit politikën e saj të re mbi institucionet dhe mbi ligjin dhe mbi çdo gjë tjetër që ndërlihdet me demokracinë dhe zhvillimin. Nëse sipas VV-së institucionet ishin të kapura nga partitë politike, sidomos nga PDK-ja, ato duhej të kapen. Kjo ç'kapje s'mund të bëhet ndryshe veç se me politikat e VV-së të cilat u legjitimuan nga më shumë se 50% e qytetarëve. Për rrjedhojë politika u ngrit mbi institucionet e shtetit. Prandaj askush nga radhët e VV-së nuk duhet të akuzohet, as dënohet, sepse ata nuk janë hajna por gjykatat janë të kapura, ose tjetra, Qeveria Kurti nuk po gabon por mediat po gënjejnë sepse janë të kapura, edhe tjetra Kushtetuta nuk po shkelet por Gjykata Kushtetuese është e kapur etj, etj.

E dyta - Ata që asnjëherë nuk mundën të identifikohen me luftën e UÇK-së u rreshtua në

fund me VV-n.

Disa që na janë dukur gjithmonë të paktë në numër, duke mos e pranuar luftën e UÇK-së si të domosdoshme, por duke e kualifikuar edhe si të dëmshme, duke mos u identifikuar me vlerat e saja, por duke i refuzuar e minimizuar ato, e sidomos duke qenë kundër atyre që ishin kryesorët në luftën e UÇK-së, gjetën vend sidomos në rradhët e VV-së. VV u bë strehë dhe fole e preferuar e të gjithë atyre që në një ose mënyrë tjetër për vite të tëra kishin ndejur anash, por edhe kishin kritikuar luftën dhe krejt rezultatet e saja. Të kuptohemi njëzëz të tillë nuk janë vetëm në VV, ka edhe në partitë tjera. Por ata që sidomos viteve të fundit u rreshtuan me VV-në ishin më konsekuent kundër UÇK-së, më stoik në mospranimin dhe kundërshtimin e vlerave të luftës, deri në krijimin e një mendimi të përpunuar politik, se këta të luftës na morrën në qafë, se këta janë vlarë mes veti, se këta kanë vlarë të tjerët, deri në atë të ligën, se këta e meritojnë të denohen në Hagë. E treta - VV-ja duke qenë kundër ndërkombëtarëve u bë sidomos antiamerikane.

Kur VV-ja si opozitë ka folur, ka vlerësuar e protestuar për dështimet në Kosovë, gjithmonë ka fajësuar edhe faktorin ndërkombëtar e më së shumti SHBA-n. Mirëpo çdo fitore e madhe e Kosovës e ka edhe vulën e SHBA-së, por këto fitore Kurti i ka lexuar si dështime e humbje. Prandaj për rrjedhojë VV-ja me Kurtin kanë qenë të bindur se SHBA-ja është fajtorja

më e madhe, pas institucioneve të Kosovës. Me ardhjen e VV-së në pushtet kjo akuzë ndaj SHBA-së është institucionalizuar. Për më keq viteve të fundit është kthyer në kulturë aktive politike në një lloj "shmekerllëku politik" që nënkupton se, për aq sa Kosova nuk koordinohet me SHBA-n për aq e forcon sovranitetin, sidomos në veri.

E katërta - VV-ja duke mohuar çdo arritje, përmbledhur në sloganin e famshëm "Qe 20 vjet e keni shkatërruar këtë vend" u bë strehë e jugo-nostalgjikëve. Jugo-nostalgjikët janë ata që e kanë pa të ardhmen e Kosovës në Jugosllavi dhe kanë besuar në këtë projekt. Për ata UÇK-ja ka qenë ekstremiste. Të kuptohemi ky nuk ishte qëllim i VV-së, pra që ti afroje të tillët, jo, por ky ishte efek anësor i veprimtarisë së saj, politike, në thelb mohuese dhe refuzuese që më së miri kuptohet nga slogani përmbysës. Në të vërtetë VV-ja jo vetëm që u bë strehë edhe e jugo-nostalgjikëve, por ju dha edhe mundësi atyre të aktivizohen politikisht. Sot në VV ka të ri e të reja me mbiemra të njohur të pushtetarëve nga e kaluara komuniste. Kjo nuk do të thotë se vetëm tek VV-ja ka të tillë. Jo, ka edhe tek partitë e tjera. Por tek VV-ja kanë hyrë ata më kokëfortët në këtë refuzim. Ata në VV u bënë bashkë si askund tjetër u konsoliduan dhe çka është unike atyre ju shkoj për dore të bëhen më të zëshëm se kurrë bile edhe të krenohen me këtë qasje.

E pesta - VV-ja u bë edhe strofull për aderimin e islamistëve

politik të Kosovës.

Duke ushqyer për kohë të gjatë antipatin e madhe jo veç politike ndaj faktorit ndërkombëtar në Kosovë, sidomos ndaj SHBA-së, VV-ja hapi derën e saj për të gjithë ata radikal që mendojnë se, sa më shumë ka antiamerikanizëm te dikush aq më shumë ka premisa për fe të vërtetë islame dhe e kundërta, ti s'mund të jesh mysliman i mirë pa qenë kundër botës perëndimore dhe sidomos SHBA-së. Një lidhje e tillë, VV - islamistë, edhe pse e tërrthortë, del të mos jetë as e vogël as e rastësishme. Kjo bëhet edhe më e çuditshme kur dihet se, në VV, as Kurti as shumë kolegë të tij partiak, nuk janë praktikues të fesë islame e shpesh janë jo besimtarë. Por si duket të ulen ata bashkë në një 'kupe treni politik' i ka bërë antiamerikanizmi.

Thënë përmbledhtazi, shtylla bazike e VV-politikës "Qe 20 vite ky vend është shkatërruar" dhe shtylla tjetër se ajo si parti është formësuar jo duke u ballafaquar me Serbinë por, me institucionet e Kosovës, me partitë politike shqiptare dhe ma faktorin ndërkombëtar, me kalimin e kohës e ka deformuar ate duke e hapur për jugo-nostalgjikët dhe për ata që s'e donin UÇK-në dhe duke e bërë antiamerikane dhe strehë e islamistëve dhe pandalshëm anti-institucionaliste.

Krejt këto e kanë deformuar VV-në për ta bërë sot të padobishme që të jetë efikase kundër Serbisë dhe e dobishme për qytetarin e Kosovës.

## Haradinaj godet Osmanin: Në çdo ndyrësi të Kurtit, ti je në mes të saj

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kritikuar ashpër qeverinë aktuale, duke akuzuar kryeministrin Albin Kurti për largimin e Kosovës nga aleatët ndërkombëtarë.

Në "Facebook", Haradinaj shprehu shqetësimin e tij për politikën e jashtme të vendit. "As armët e blera kineze, as armët e blera ruse, as lufta e madhe hibride serbo-ruse në Kosovë, as strukturat kriminale serbe në territorin e Kosovës nuk e kanë ndihmuar agjendën serbe në Kosovë aq sa e ka ndihmuar Albin Kurti me politikën e tij anti-amerikane dhe kundër aleatëve. Serbia do të jepte miliarda vetëm që ta largonte Kosovën nga mbrojtja amerikane dhe vendet e tjera aleate. Albini e largoi Kosovën pa pagesë fare. Politika e Kurtit sot në Uashington çdo ditë e më shumë konsiderohet si politikë

gati armiqësore, kurse Evropa e udhëhequr nga Gjermania, me atë që tha Sarrazin, po e përjashton Kosovën nga Procesi i Berlinit dhe nga çdo nismë rajonale. Evropa po instalon politikë 6 minus 1 në Ballkanin Perëndimor. Ky minus është Kosova: e përjashtuar nga çdo proces integruar, e sanksionuar dhe me prirje të fuqizimit të sanksioneve dhe masave të tjera izoluese", ka shkruar Haradinaj. Ai ka thënë se Kosova ka një presidente koti që pas katër vitesh qeverisje merr guxim të dalë në televizion dhe për 40 minuta të flasë sa e rëndësishme është ShBA-ja për Kosovën që, sipas tij, sikur gjatë këtyre katër viteve ajo të kishte qenë në hënë. "Një përpjekje e mjerë për ta hequr përgjegjësinë nga vetja dhe për ta ngarkuar vetëm Kurtin. Gabim, zonja Presidente. Në çdo ndyrësi të Kurtit, ti je në mes të saj", ka thënë Haradinaj.





## “Trepça” ka krizë të prodhimit

**PRISHTINË, 9 SHTATOR** - Kombinati metalurgjik “Trepça” nuk ka arritur deri më tash ta prodhojë as gjysmën e produkteve të përshkruara në planin e tij të biznesit për vitin 2024, kryesisht për shkak të grevave të punëtorëve dhe mungesës së lëndës së parë.

Nga janari deri në gusht minatorët nuk kanë punuar 74 ditë pune. E pagat e tyre varen nga prodhimi, përkatësisht shitja e produkteve.

Më 27 gusht udhëheqja e “Trepçës” shpalli gjendje të jashtëzakonshme për shkak të, siç tha, humbjeve të mëdha ditore në prodhim, dhe vendosi t’i pezullojë përkohësisht pushimet vjetore të punëtorëve për muajin shtator, tetor dhe nëntor të këtij viti.

Dikur motor i ekonomisë së Kosovës, “Trepça” prej vitesh përballlet me prodhim të reduktuar, edhe pse treg për shitje ka, konfirmojnë nga kombinati.

Kombinati operon me 13 njësi biznesore në terriore të ndryshme të Kosovës.

Miniera e Stantërgut është vendburimi kryesor i xehes, pasuar nga miniera me flotacion e Kishnicës dhe e Artanës.

“Radio Evropa e Lirë” analizoi Planin e Biznesit 2024 për këto njësi, ku për këtë vit ishte e planifikuar të prodhoheshin mbi 210 mijë tonë xehe dhe koncentrate të plumbit dhe zinkut - mbi 160 mijë tonë në Minierën e Stantërgut dhe mbi 41 mijë tonë në Minierën e Kishnicës dhe atë të Artanës. Por, Miniera e Stantërgut deri në muajin gusht ka arritur të prodhojë vetëm rreth 53 mijë tonë xehe, ose të realizojë 1/3 e planit dinamik, thotë drejtori i prodhimit të këtij flotacioni, Bujar Jashari për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas tij, arsytet për nënprodhim lidhen me ndërprerjen e punës për shkak të grevave, mungesën e lëndës së parë që sigurohet nga kompanitë private, si dhe keqmanaxhimin në kombinat. “Fillimisht, në muajt mars-prill, nuk ka pasur për 32 ditë prodhim, sepse ka munguar lënda e parë - eksplozivi”, thotë Jashari. Sipas tij, minatorët nuk kanë punuar



për 35 ditë të tjera në muajt korrik dhe gusht për shkak të mosrealizimit të pagës, e ngjashëm as shtatë ditë në qershor.

“Radio Evropa e Lirë” nuk mori përgjigje nga udhëheqësit e Minierës së Artanës dhe të Kishnicës për sasinë e prodhimit. Por, në vendimin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, të siguruar nga REL-i, thuhet se në dy flotacionet, Stantërg dhe Kishnicë e Artanë, nga data 10 korrik deri më 15 gusht “ka pasur humbje të mëdha ditore në prodhim dhe ndalesë për realizimin e planit të biznesit”.

Në vendim parashihet mobilizimi i të gjitha kapaciteteve për ta stabilizuar gjendjen operative dhe financiare të ndërmarrjes.

Një ditë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, udhëheqja e “Trepçës” tha përmes një postimi në “Facebook” se “gjatë pjesës së mbetur të vitit, ndërmarrja synon rritjen e prodhimit dhe kufizimin e shpenzimeve sipas një plani të veprimit të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës”.

Kryetari i Sindikatës së Minatorëve, Ibrahim Jonuzi, tregon se të gjithë minatorët janë në vendet e tyre të punës dhe se janë duke punuar me intensitet të lartë. “Problem, aktualisht, janë pajisjet e vjetruara,

makineritë... Dhe kjo po ndikon në sasinë e prodhimit”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

### Për katër vjet mbi 28 milionë euro nga qeveria

Për të njëjtin qëllim mjete janë ndarë edhe në vitet e kaluara. “Për paga dhe shërbime operative, qeveria, përgjatë katër viteve të kaluara, ka ndarë mbi 28 milionë euro”, thuhet në një deklaratë me shkrim që udhëheqja e Trepçës i dërgoi “REL”-it. “Shumica e mjeteve kanë shkuar për paga dhe shpenzime operative në prodhim”, sipas saj.

Bashkim Kurti, i cili deri në fillim të gushtit ishte kryeshef ekzekutiv i Trepçës, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se ndërmarrja ka makineri të vjetruara, por shpreh bindjen se edhe me kushte të tilla mund t’i sigurojë të hyrat e nevojshme për paga dhe shpenzime. “Nuk mund të prodhohet nëse [minatorët] nuk i bëjnë as tri orë punë efektive. Këtu është problemi kryesor dhe kjo qasje duhet të ndryshojë. Produktet e Trepçës kanë treg të mjaftueshëm, por nuk ka prodhim”, thotë ai.

Pagat e minatorëve në “Trepçë” sillen nga 700 deri në 900 euro, varësisht përvojës dhe përgatitjes profesionale. Ata nuk kanë as sigurime shëndetësore, as

jetësore, ndërsa incidente në kombinat ndodhin vazhdimisht. “Radio Evropa e Lirë” ka raportuar disa herë sesi minatorët, përveçse me makineri të vjetruar, përballen edhe me mungesë të kushteve elementare, si çizme apo helmata. E kontaktuar nga “Radio Evropa e Lirë”, Qeveria e Kosovës nuk u përgjigj në pyetjen se a ka plane për investime. Megjithatë, ajo ka kërkuar disa herë nga menaxhmenti i Trepçës që ta rrisë prodhimin, rrjedhimisht edhe të hyrat financiare.

Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka takuar më 23 gusht disa nga minatorët në Stantërg. Ajo ka thënë se qeveria është e gatshme të investojë në “Trepçë”, “vetëm kur të vihet në vend drejtësia”, pa treguar më konkretisht se për çfarë drejtësie e ka fjalën. Me gjithë përpjekjet, as “REL”-i nuk ka arritur të bjerë në kontakt me të.

### Si të ringjallet “Trepça”?

Tregu, ku aktualisht eksporton “Trepça”, është ai evropian. Sipas deklaratës së udhëheqjes së “Trepçës” për REL-in, në pesë vitet e fundit produktet e saj shiten në Zvicër, Angli dhe Bullgari. Por, pavarësisht prej sigurisë së tregut, vetëm me shitjen e koncentrateve, “Trepça” nuk mund të mbijetojë, thotë Izet

Ibrahimi, profesor në Fakultetin e Gjeoshkencave në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Ringjallja e “Trepçës”, sipas tij, mund të ndodhë vetëm nëse pjesërisht kalon në duart e sektorit privat, sepse investimet nga qeveria janë për mbijetesë dhe jo për zhvillimin e saj. “Të gjitha qeveritë në vazhdimësi, të ndikuara nga ana emocionale, dëshirojnë ta ruajnë pronësinë shoqërore - që unë mendoj se është gabim i madh. Ekziston forma e partneritetit publiko-privat apo me koncesion që të jepet një sektor, siç është metalurgjia, përpunimi i produkteve...”, thotë Ibrahimi. Qeveria e Kosovës nuk u përgjigj as në pyetjen se a ka mundësi që “Trepça” të privatizohet pjesërisht.

Jashari thotë se “minatorët punojnë në kushte mesjetare”. “Për të pasur prodhim, duhet të ketë teknologji. Makinat janë të vjetruara, mirëmbajtja është e shtrenjtë. Më llogari ke ta blesh të re sesa ta mirëmbash ndonjë makinë”, sipas tij.

Kompleksi metalurgjik “Trepça”, që gjendet në rajonin e Mitrovicës, është shoqëri aksionare - 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.

Produktet kryesore që prodhohen atje janë xehet dhe koncentratet e plumbit dhe zinkut me përmbajtje të argjendit, arit dhe elementeve të tjera.

Deri në vitet ’90, kur është përkeqësuar situata politike, “Trepça” është llogaritur si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e Jugosllavisë së atëhershme.

Në periudhën pas ka nisur rënia e prodhimit dhe zvogëlimi i numrit të punëtorëve - nga rreth 20 000 atëkohë, sot i ka rreth 700 minatorë.

Makineritë e vjetruara mbi 50 vjet dhe mungesa e mirëmbajtjes janë shndërruar në probleme të vazhdueshme.

Greva të punëtorëve, në kërkim të kushteve më të mira dhe pagave më të larta, ka kohë pas kohe.

## Latifi: Festa e vjeljes së rrushit ‘Hardh Fest 2024’ ishte një atmosferë e përsosur

**RAHOVEC, 9 SHTATOR** - Për tri ditë, më 6, 7 dhe 8 shtator, qytetarë nga Kosova, bashkëkombës nga trevat shqiptare dhe nga vende të ndryshme të botës, morën pjesë në aktivitetet e begatshme dhe në koncertet e Festivalit “Hardh Fest 2024”.

Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se festa e vjeljes së rrushit “Hardh Fest 2024” ishte një atmosferë e përsosur, ku pati një publik të jashtëzakonshëm dhe kaloi pa asnjë incident. Ai ka thënë se festa e rrushit, që dikur festohej thjesht nga vreshtarët

e Rahovecit, tani është një festival madhështor që tërheq vizitorë nga e gjithë bota. “Një kombinim i përkryer mes argëtimit, traditave dhe përvojave unike, ku të gjithë patën mundësinë ta përjetojnë mikpritjen e ngrohtë dhe bujarinë tonë, ta shijojnë verën dhe rakinë rahovecase, ta njohin trashëgiminë tonë kulturore dhe natyrore si dhe potencialet turistike. Një falënderim i veçantë shkon për institucionet, për delegacionet e shumta, për ambasadat dhe për të gjithë partnerët që morën pjesë, duke e bërë këtë

festival edhe më të rëndësishëm. Publiku ka treguar një nivel të lartë kulture dhe ka krijuar atmosferë të përkryer gjatë gjithë festivalit. Falënderojmë këshillin organizues, në krye me drejtorin ekzekutiv Agron Sokoli, për përkushtimin e jashtëzakonshëm. Po ashtu, një falënderim për Policinë e Kosovës dhe për ekipet e tjera të sigurisë, për ekipet e pastrimit dhe mirëmbajtjes, për QKMF-në dhe për zjarrfikësit që kontribuan për sigurinë në festival!”, ka thënë Latifi.





# Frymëzimi nga Shekspiri, Floberi dhe hartuesit e Fjalorit anglisht të Oksfordit

Julian BARNES,  
shkrimtar anglez

## Libri i parë që kam lexuar

Ka shumë gjasa të jetë një nga librat e serisë së librave Nodi të Enid Blytonit. Besoja me të vërtetë realitetin e Toilandit dhe doja të ngjisja një makinë si ajo e Nodit (edhe pse ishte taksi).

## Libri im i parapëlqyer ndërsa rritesha

Spid Siks e Bruce Carterit, për një makinë britanike [Bentley] të paraluftës [së Dytë Botërore], e lyer me ngjyrë të gjelbër, e cila ua kalon shumë makinave të huaja të pasluftës – të markës Maserati dhe të tjera – ideale për Anglinë e vogël [Little Englander].

## Libri që më ndryshoi kur isha adoleshent

Isha veshur me uniformën e ushtrisë për një ditë stërvitjeje në terren, si pjesë e Forcave të Kombinuara të Kadetëve, dhe në kohën e drekës nga kutia e ushqimit nxora një kopje të shtëpisë botuese "Penguin", të veprës Krim dhe ndëshkim të Dostojevskit. Pavarësisht largësisë së kohës dhe vendit, gjuhës dhe mjedisit shoqëror, e

dija se ngjante shumë më tepër me atë që ishte jeta sesa skenat që ndodhnin rreth meje.

## Shkrimtari që më ndryshoi mendjen

Shekspiri, Floberi dhe hartuesit e Fjalorit anglisht të Oksfordit.

## Libri që më ngjalli dëshirën të bëhesha shkrimtar

Sigurisht që nuk kishte asnjë libër të vetëm dhe kurrë nuk mendova se mund të "bëhesha shkrimtar" – vetëbesimin e kisha shumë të dobët për këtë. Shpresoja të shkruaja një libër të vetëm dhe ta botoja. Më pas, gjërat dolën pak jashtë kontrolli. Pa dyshim që tani jam shkrimtar.

## Libri apo autori të cilit i jam kthyer

EM Forster. Kur e lexova për herë të parë, në adoleshencën time dhe në të 20-at, mendova se ishte i denjë, por deri diku i dobët. Dyzet vjet më vonë, lexova përshkrimin e tij për një vakt mëngjesi të tmerrshëm anglez të servitur në trenin që shkonte drejt një porti, herët në mëngjes nga Harwiçi, dhe kuptova se ai mund të ishte shumë argëtues. Pastaj i provova përsëri romanet dhe kuptova se çfarë mjeshtëri ishte ai –



thellësisht serioz, jashtëzakonisht liberal, zbatimës pa e kuptuar.

## Libri që kam rilexuar

Përafërsisht në intervale prej pesë vjetësh, rilexoj Ushtari i mirë i Ford Madox Fordit, Një hero i kohës sonë të Mikhail

Lermontovit dhe Fillimi i pranverës të Penelope Fitzgeraldit. Secili ka misterin dhe magjinë e vet, të cilën ende kërkoj ta gjej.

## Libri që s'kam mundur ta lexoj më

Katër romanet Aleksandria të

Lawrence Durrellit, i cili 50 vjet më parë dukej i lezetshëm dhe joshës, plot me njerëz dhe vepra të cilat nuk i njohja për shkak të mungesës së përvojës dhe kisha frikë se nuk do t'i njihja kurrë. Tani më duket thjesht ekstravagant dhe provokues.

## Libri që zbulova më vonë në jetë

Xhejn Ejr, padyshim një nga tre romanet më të mëdhenj të shekullit XIX, së bashku me Bindja dhe Midëlmars.

## Librat që jam duke lexuar ndërkohë

Memoarin e dhimbshëm të David Storeyt, Ngazëllim therës dhe Dëshmitarët e fundit të Svetlana Alexievichit.

## Leximet për qejf

Vështirë të quhen lexime për qejf, sepse pikëpamja e tij për jetën dhe motivimin njerëzor është shumë pesimiste, por gjithmonë pranë vetes kam një vepër të Simenonit. Në ditët e sotme më shumë romanet e thella sesa historitë e detektivit Megre. Dhe, ka kaq shumë, sa që nuk mbarojnë kurrë! /ExLibris/ Përktheu: Granit Zela.

## Pushtimi kulturor i Indisë në lashtësi

Nga: Tanjil RASHID /  
The Financial Times

Kur isha fëmijë dhe po mësoja bazat e fesë, më treguan një përrallë interesante nga tradita islame. Tre të verbër, që ishin kurthuar në xhungël, u ndeshën me atë që, pa e ditur ata, ishte një elefant. Njeriu i parë, pasi preku feçkën e tij, mendoi se ishte një grykë uji. I dyti, pasi u përplas te veshët e elefantit, besoi se kishte gjetur një freskuese. I fundit hipi mbi elefant dhe tha se po qëndronte ulur në një fron. Mësimi është ky: ka vetëm një Zot, por, në përpjekjen për ta perceptuar Atë, jemi si njerëzit e verbër përpara atij elefanti.

Për lashtësinë e kësaj shëmbëlltore mësova kohët e fundit. Historiani i vlerësuar me shumë çmime, William Dalrymple, na rrëfen një version të saj në Rugën e Artë [The Golden Road], që është një histori e jashtëzakonshme e pushtimit kulturor të globit nga India e lashtë. Ky "tregim nga sufizmi" rreth të verbërve dhe elefantit, në fakt, u bart në Islam nga budizmi, përkthyer nga burimet indiane për jetën e Budës, një mijë apo më shumë vjet para Muhamedit.

Ata që kanë pasur një fëmijëri tipike perëndimore do të gjejnë gjithashtu momente zbulimi në Rugën e Artë. Kumaraxhiva, për shembull, ishte një murg me origjinë indiane që përktheu Sutrën e zambakut të bardhë [Lotus Sutra], një tekst kyç budist, nga sanskritishtja në kinezisht. Ai përmendi se si një kritik

e krahasoi idenë e tij me endësin, i cili kishte për detyrë të thurte fillin më të mirë të mundshëm. Kur çdo përpjekje binte poshtë, endësi tregoi ajrin, duke e bindur klientin e tij të vështirë se ai kishte thurur një fije aq të hollë sa që syri nuk mund ta shihnte atë. Është, thotë Dalrymple, një "version i hershëm i Rrobave të reja të Perandorit".

Rruga e Artë është një histori tërheqëse letrare, një tregim me tregime, dhe sipas Dalrympleit, kjo u arrit kryesisht përmes përhapjes së fjalëve – përfshirë idetë dhe doktrinën e dhëna në formë narrative – me të cilat India e lashtë "transformoi botën". Përafërsisht midis viteve 250 para Krishtit dhe 1200 pas Krishtit, përrallat indiane si Ramajana, epika e lashtë hinduiste, mbërthyen imagjinatën e pothuajse çdo qytetërimi në botën e vjetër.

Ato u përkthyer në shumë gjuhë dhe u përshkruan në dorëshkrimet që gjendeshin në bibliotekat e Bagdadit dhe Aleksandrisë. Disa nga fabulat e Ezopit kanë origjinën në antologjitë e lashta të tregimeve indiane, si dhe në Netët arabe. Njëpërmjet përkthimeve në arabisht, jeta e Budës në krishterim u bë historia e shenjtorëve Varlam dhe Jozafat. Dalrymple ndalet pak te ata studiues indianë që thonë se edhe historia e lindjes së Krishtit është me origjinë budiste, por ai citon gjithashtu pretendimin interesant se personazhi i Djallit, "i cili mungonte në judaizmin e hershëm", mund të ketë ardhur nga India.



Këto tregime, të ndryshuara me kalimin e kohës, hedhën një magji, fuqia e së cilës vazhdon dhe shtrihet në të gjithë Azinë. "Më shumë se gjysma e popullsisë së botës sot jeton në zonat", thotë Dalrymple, "ku perënditë indiane sundonin imagjinatën dhe aspiratat e burrave dhe grave". Për shembull, linja ajrore kombëtare e Indonezisë, Garuda, është emëruar sipas malit të Vishnus, ndërsa qyteti tajlandez Ajutaja, kryeqyteti i lashtë i vendit, është emëruar sipas Ajodhjas së Indisë, vendlindjes legjendare të Ramës.

Talentet e Dalrympleit përfshijnë udhëpërshkrimin dhe kritikën e artit, dhe ai na ndihmon të përfytyrojmë madhështinë e kësaj trashëgimie kulturore, duke na çuar në një turne në vende si Angkor Vat dhe Borobudur, përkatësisht tempujt më të mëdhenj të hinduizmit dhe budizmit në botë. Asnjëri prej tyre nuk është në Indi,

ku të dy fetë kanë origjinën. Angkora – nga sanskritishtja "nagara", që do të thotë qytet mbretëror – ishte ish-kryeqyteti i madh i Kamboxhias, ndërsa stupat piramidale të Borobudurit shtrihen në Indonezi. Si vende adhurimi dhe pelegrinazhi, ato ende na tregojnë se si India u ngulit jashtë vendit. Prova të tilla fizike mbështesin rastin e Dalrympleit për rolin qendror të Indisë në historinë e lashtë. Vendi, në fund të fundit, ishte burim mallrash dhe idesh, të cilat u përhapën përgjatë të njëjtave rrugë tregtare. Sumerët, qytetërimi më i hershëm në botë, përdorën drurin e tikut dhe mermerin indian. Lukset e tilla si xhenxhefil, piperi dhe indigoja (fjalë me rrënjë indiane) u treguan për ar, duke bërë që Plini Plaku ta quante Indinë "lavamani i metaleve më të çmuara në botë". India ishte, siç tregon Dalrymple, partneri më i madh tregtar i Romës së lashtë.

Të gjitha këto janë fakte të njohura nga historia, dhe bibliografia me 50 faqe, përmbledhen në një sintezë mjeshtërore, përfshirë punën e historianëve nacionalistë indianë të mesit të shekullit XX nga Bengali – megjithëse

Dalrymple paralajmëron se ata përsëritën disa nga paragjykimet kolonialiste. Ai merret me identifikimin e rrjetit që lidhi pasurinë dhe mençurinë e Indisë me botën përtej brigjeve të saj, me shtigjet e "rrugëve të lundrueshme detare dhe rrugëve tregtare" që Dalrymple i quan "Rruga e Artë", të cilës "deri tani nuk i ishte vënë kurrë një emër".

A është kjo një ekzagjerim? Analiza e Dalrympleit sjell krahasimin me "tregtinë e erëzave", rrugët detare midis Azisë dhe Evropës që historianët i kanë krahasuar prej kohësh me Rugën tokësore të Mëndafshit drejt dhe nga Kina. Dalrymple e vendos Rugën e tij të Artë përballë "konceptit joshës sinocentrik" të Rugës së Mëndafshit, i cili "pothuajse nuk ekzistonte në antikitet".

Kina e Xi Jinpingut sot është shumë më e aftë në promovimin e vetvetes si zemra e Azisë. Por, në fund të fundit, nuk mund të krahasohet me dhuratën fillestare të Indisë për mitin dhe tregimin, dhe kjo është ajo që Dalrymple ka kanalizuar me kaq sukses në Rugën e Artë. Përmbytja, veçanërisht për aziatikët e Jugut, mund të jetë e vjetër, por ky është ritregimi më bindës që kemi pasur ndër breza. /Telegrafi/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON Inverit  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Kosova harron humbjen e dhimbshme ndaj Rumanisë, triumfon me 4:0 ndaj Qipros

**QIPRO 9 SHTATOR, 2024** - Kombëtarja e Kosovës ka shënuar fitore bindëse në ndeshjen ndaj Qipros, të hënën mbrëma, në Larnaca, duke triumfuar me rezultat 4:0. Kjo ishte fitorja e parë për Dardanët në edicionin e katërt të Ligës së Kombeve, ku ekipi ynë dominoi plotësisht ndeshjen dhe tregoi një paraqitje mbresëlënëse. Kosova tregoi qartë superioritetin e saj ndaj rivalit në çdo aspekt dhe atë që nga fillimi. Pas humbjes në ndeshjen e fundit ndaj Rumanisë, Dardanët rikthyen besimin me një performancë



Albion Rrahmani zëvendësoi Muriqin dhe Lumbardh Dellova zëvendësoi Fidan



të shkëlqyer. Qiproja, që kishte fituar ndeshjen e fundit ndaj Lituanisë, ishte pa gjasa përballë lojës së shpejtë dhe të organizuar të ekipit të Kosovës. Kosova e nisi furishëm ndeshjen, duke shënuar golin e parë që në minutën e 9-të. Donat Rrudhani fitoi një penallti, të cilën Vedat Muriqi e shndërroi në gol për epërsinë 1:0. Nuk vonoi shumë dhe në minutën e 21-të, pas një harkimi të saktë nga Rrudhani, Muriqi realizoi sërish me kokë për rezultatin 2:0. Pjesa e parë u mbyll me dominim të plotë nga Dardanët. Pjesa e dytë filloi me disa ndryshime taktike nga Kosova.

Alitin. Ky ndryshim dha rezultate të menjëhershëm, me Rrahmanin që realizoi golin e

tretë në minutën e 48-të pas një asistimi të bukur nga Milot Rashica.

Në minutën e 55-të, pas një aksioni të koordinuar mirë, Rrudhani pasoi në zonë për Lumbardh Dellovën, i cili goditi me saktësi për të vulosur rezultatin 4:0.

Përzgjedhësi Franco Foda vazhdoi me rotacionin e lojtarëve, duke inkuadruar edhe Ilir Krasniqin, Emir Sahitin dhe Eliot Bujupin, i cili bëri debutimin e tij me ekipin kombëtar. Pak para fundit Emir Sahiti pati një mundësi të shkëlqyer për të shënuar, por goditja e tij qëlloi shtyllën.

Kjo fitore e ngre moralin e ekipit dhe tregon përkushtimin e lojtarëve për të dhënë më të mirën e tyre në çdo ndeshje pasuese.

| League C, Group 2 |           |   |   |   |   |       |     |
|-------------------|-----------|---|---|---|---|-------|-----|
| All Home Away     |           |   |   |   |   |       |     |
| #                 | Team      | P | W | D | L | Goals | PTS |
| 1                 | Romania   | 2 | 2 | 0 | 0 | 6:1   | 6   |
| 2                 | Kosovo    | 2 | 1 | 0 | 1 | 4:3   | 3   |
| 3                 | Cyprus    | 2 | 1 | 0 | 1 | 1:4   | 3   |
| 4                 | Lithuania | 2 | 0 | 0 | 2 | 1:4   | 0   |

## SHKURT

### Nuza, gjyqtar kryesor për ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Evropian U21

Genc Nuza do ta gjykojë ndeshjen kualifikuese për Evropianin U21. UEFA u beson përsëri gjyqtarëve nga Kosova për ta ndarë drejtësinë në kompeticione të nivelit të lartë. Ndeshja e Grupit H, Slovenia U21 - Qipro U21, do të gjykohet nga gjyqtari i Kosovës, Genc Nuza. Në këtë ndeshje, që do të zhvillohet në stadiumin "Mestni Stadion Fazanerija" në Murska Sobota, gjyqtari Nuza do të asistojë nga Besnik Morina dhe Arbnor Bullatovci, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Erdall Zasella. Kjo ndeshje do të zhvillohet të martën, më 10 shtator, me fillim në orën 18:00.

### Thaqi rikthehet te Gjilani

Skuadra e Gjilanit e ka paraqitur futbollistin e krahut të djathtë, Armend Thaqi. Thaqi rikthehet në klub pas përvojave tejet të suksesshme te Klubi i Prishtinës dhe Ballkanit duke fituar gjithçka që mund të fitohet në futbollin e Kosovës, derisa qëndroi edhe për një kohë jo shumë të gjatë te gjiganti rumun CFR Cluj. "Klubi dhe futbollisti ndodhen sërish në marrëdhënie pune, pas aventurës tejet pozitive në edicionet 2016-2018. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet 'kuqebardhëve' dhe anësorit të krahut të djathtë është e vlefshme deri në verën e vitit 2026", thuhet në njoftimin e Gjilanit. 31-vjeçari ishte pjesë e Përfaqësueses së Kosovës në disa grumbullime, teksa ka debutuar edhe në ndeshje zyrtare. Thaqi është bashkuar me pjesën tjetër të skuadrës, derisa do të ketë drejtë loje qysh nga ndeshja e ardhshme ndaj FC Feronikeli '74. Drejtori gjeneral i klubit Syart Rrahmani e ka mirëpritur futbollistin dhe i ka uruar shumë suksese në rikthimin te "shtëpia" e vjetër.

### Yakin: Xhaka nuk mund të zëvendësohet


Granit Xhaka nuk mund të zëvendësohet. Selektori i Zvicrës, Murat Yakin, ka thënë se mungesa e Granit Xhakës ishte kyçe në mosarritjen e një rezultati në ndeshjen që kombëtarja helvete e humbi 4-1 ndaj Spanjës. Në një deklaratë pas ndeshjes, Yakin vendosi të mos e gjykojë shumë ashpër ekipin e tij. "Kemi luajtur një ndeshje të mirë deri në 1:2, pastaj kemi humbur pak durimin. Shumë lojtarë nuk janë ende në ritëm dhe kërkojnë formë", ka thënë Yakin. "Ne nuk duhet ta përdorim Spanjën si pikë referimi. Nëse duam të mbijetojmë kundër skuadrave të tilla, duhet të kemi 14 deri në 16 lojtarë që janë në këtë ritëm", ka shtuar ai. Kjo është arsyeja pse mungesat e Dan Ndoye, Silvan Ēidmer, Nico Elvedi dhe mbi të gjitha ajo e Granit Xhakës ishin të konsiderueshme. Mungesa e kapitenit ra në sy që në minutën e parë, shkruan "Blick". "Loja jonë bazohet në zotërimin e topit. Nëse mungon graniti, mungojnë lidhjet dhe zgjidhjet që ai ofron", thotë Yakin. Edhe pse Yakin shprehu pakënaqësinë e tij për paraqitjen e zëvendësuesit të Xhakës, Denis Zakaria, ai e mbrojti edhe atë. "Denisi është një lloj tjetër lojtari që lulëzon me dinamizmin e tij".

## FC Ballkani paraqet trajnerin Artim Pollozhani

**SUHAREKË, 9 SHTATOR** - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, FC Ballkani, e ka paraqitur trajnerin e ri Artim Pollozhani. Ky i fundit edhe në të kaluarën ishte pjesë e skuadrës nga Suhareka, duke qenë ndihmëstrajner i Ilir Dajës. "Mirë se u ktheve në shtëpinë

tënde, Artim Pollozhani! Është një nder dhe kënaqësi e madhe që të kemi si kryetrajner të ri të FC Ballkanit. Përvoja dhe njohuritë e tua për klubin tonë janë një vlerë e shtuar, ku së bashku synojmë të ecim edhe më shumë drejt qëllimeve tona. Të urojmë një rifillim sa më të

suksesshëm në këtë rrugëtim të ri. Na priftë e mbara Pollo!," thuhet në njoftimin e Ballkanit. Skuadra e Ballkanit është eliminuar nga garat evropiane, derisa në Superligë nga katër ndeshjet e zhvilluara ka grumbulluar 7 pikë dhe është në krye të tabelës.





## Ismajli në formacionin e javës në Ligën e Kombeve

**TIRANË, 9 SHTATOR** - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Ardjan Ismajli, zhvilloi një ndeshje fantastike ndaj Ukrainës, duke shënuar një gol, por ishte i pakalueshëm në mbrojtje duke evituar të paktën një gol të sigurt. Lojtari

më i mirë i ndeshjes me qartësi dhe saktësi në çdo minutë të luajtur duke i dhënë siguri trajnerit në mbrojtje dhe mbështetje e forcë edhe në fazë sulmuese. Kompania e statistikave në futboll "Sofascore" e ka vlerësuar

Ismajlin për këtë paraqitje duke i dhënë një vend në formacionin më të mirë të ndeshjeve të para të Ligës së Kombeve. Nota për të 8.3 në një rreshtim ku ka emra të mëdhenj si Kevin De Bruyne apo edhe gjeorgjiani

Kvaratskhelia. Musiala apo edhe Declan Rice. Ardian Ismajli u la jashtë formacionit të kombëtares në Kampionatin Evropian, por ai tregoi të shtunën se e meriton të jetë pjesë e formacionit. Formacioni: Johansson,



Volkov, Ismajli, Rubeziq, Rice, Wirtz, De Bryune, Musiala, Kvaratskhelia, Gyokeres, Isak.

## FFK-ja nis programin e ri 'Futbolli për shkolla'

**PRISHTINË, 9 SHTATOR** - Federata e Futbollit e Kosovës ka nisur implementimin e programit "Futbolli për shkolla" i cili është një program i menaxhuar nga FIFA. Ky program ka për qëllim të kontribuojë në edukimin, zhvillimin dhe fuqizimin e rreth 700 milionë fëmijëve në të gjithë botën. "Futbolli për shkolla" synon ta bëjë futbollin më të qashtë për djemtë dhe vajzat, duke përfshirë aktivitetet e futbollit në sistemin edukativ. Programi është dizajnuar për të promovuar aftësi dhe vlerë të jetësore përmes futbollit dhe për të kontribuar në zhvillimin e fëmijëve si individë të mirë për shoqërinë. Me anë të këtij projekti, FIFA dhe FFK do të krijojnë një ambient mbështetës, gjithëpërfshirës dhe do të kujdesen që ta promovojnë mësimin dhe zhvillimin individual, së bashku me një kombinim të futbollit.

Programi "Futbolli për shkolla" është i përputhur me politikën globale të sportit, edukimit dhe shëndetit, me qëllimin parësor për t'i avancuar përparësitë e zhvillimit. Antonio Buenano nga FIFA, i cili është menaxheri i projektit "Futbolli për shkolla", tha për faqen zyrtare të FFK-së se ky është një program



shumë i veçantë sepse lidh edukimin me futbollin. "Me anë të këtij programi do të bëjmë aftësimin e fëmijëve për jetën dhe në të njëjtën kohë edhe për futbollin. Pra, përmes lojës së futbollit do të ndihmojmë fëmijët që të bëhen qytetarë më të mirë. Ky është fillimi i programit, me anë të të cilit do të trajnohen rreth 50 edukatorë dhe arsimtarë të edukatës fizike, të cilët njohuritë e tyre do t'i shfaqin te kolegët e tyre, kështu duke e rritur rrejtën e këtij programi", ka thënë Buenano. Përderisa përgjegjësja e këtij projekti në FFK, Albina Rrahmani, e cilësoi këtë projekt si një hap të rëndësishëm zhvillimor drejt objektivave të FFK-së, gjithëpërfshirës dhe shtrirjes në

tërë vendin. "Aktualisht kemi 40 profesorë të edukatës fizike të cilët janë ura lidhëse mes fëmijëve, shkollave dhe programit, me anë të të cilëve do ta bëjmë rritjen e rrejtës së futbollit", ka thënë Rrahmani. Aktualisht, në fazën e parë treditore janë përfshirë komunat e Pejës, Prizrenit, Podujevës, Mitrovicës dhe Gjilanit. "Futbolli në shkolla" do të vazhdojë ta rrisë shtrirjen në tërë Kosovën me qëllimin e vetëm që, me anë të lojës më të famshme në botë, futbollit, të kontribuojë në ndryshimin individual dhe atë të komunitetit.

## Daja: Shumë krenar për atë që arrita me Ballkanin

**TIRANË, 9 SHTATOR** - Trajneri Ilir Daja ka folur për herë të parë pas largimit nga kampioni i Kosovës në futboll, Ballkani. Ai e ka cilësuar të jashtëzakonshme punën me skuadrën nga Suhareka. Ai u largua nga Ballkani në fillim të këtij muaji. "I keqardhur kam pranuar faktin se është momenti që rrugët tona të ndahen pas 973 ditësh të vrullshme, të jashtëzakonshme, emocionuese dhe, mbi të gjitha, me rezultate historike. Në këtë moment do të doja të përqafoja dhe falënderoja secilin nga ju që e bëri aventurën time në Suharekë më të mirën në aspektin njerëzor dhe profesional, duke filluar nga presidenti Arsim Kabashi, familjarët dhe bashkëpunëtorët e tij, secili nga anëtarët e stafit tim teknik, çdonjërin nga futbollistët, tifoz, veçmas



'Xhebrailat', çdo qytetar të Suharekës, falënderime dhe mirënjohje pa fund", ka shkruar Daja në "Facebook". Ai ka falënderuar edhe opinionin e gjerë sportiv të Kosovës, kundërshtarët në fushë, tifozët e klubeve të ndryshme, po ashtu edhe mediet. "Largohem nga Suhareka shumë krenar për çdo ditë të punës time aty, për çdo fitore, trofe e sukses

në garat evropiane. Pafundësisht mirënjohës për të gjithë, jashtëzakonisht i lumtur në qytetin dhe klubin ku erdha si mysafir dhe largohem i përmëshur dhe ndjesinë e një pjesëtari të familjes së madhe Ballkani, së cilës i uroj dhe dëshiroj suksese të reja dhe më të mëdha. Faleminderit Ballkani!"

Tiranasi Daja ka shkruar histori në futbollin e Kosovës. Ai e mori drejtimin e Ballkanit në janar të vitit 2022. E ka udhëhequr skuadrën drejt tre titujve të kampionit të Kosovës. Me Dajën në krye, Ballkani ka arritur dy herë në fazën grupore të Ligës së Konferencës, madje ka synuar avancimin në fazën nokaut. Ka fituar edhe një kupë të Kosovës dhe dy superkupa të Kosovës. Daja ka nisur punën te Dinamo e Tiranës.

### SHKURT

#### Ronaldo: Faleminderit për mbështetjen, Portugali!

Cristiano Ronaldo ishte vendimtar në fitoren e Portugalisë në përballje me Skocinë (2-1). Ylli portugez, edhe pse hyri si zëvendësues, e shënoi golin e fitores dhe të 901 në karrierë. Ronaldo pas këtij suksesi falënderoi tifozët për mbështetjen. "2 ndeshje 2 fitore. Faleminderit për mbështetjen, Portugali!", ka shkruar Ronaldo në rrjetet e tij sociale.

#### Sinner triumfon në US Open

Jannik Sinner fiton MAJORIN e dytë të karrierës së tij. Pas fitores së Australian Open në janar, 23-vjeçari nga Tiroli i Jugut, numri 1 i botës, pushtoi edhe Amerikën duke shkatërruar amerikanin Taylor Fritz, i 12-ti në renditje, në finalen e US Open. Jannik Sinner dominon finalen ndaj Taylor Fritz duke fituar 6-3 6-4 7-5 dhe kështu bëhet italian i parë në historinë e tenisit për meshkuj që fiton US Open. Për studentin e Vagnozzit dhe Cahillit është Slami i dytë i sezonit pas Australian Open, por edhe titulli i 6-të nga 6 finala e luajtura në vitin 2024. Sinner konfirmon kështu veten si nr. 1 në botë dhe bëhet italian i parë me dy goditje në dy turne të ndryshëm. Fjalët e numrit 1 të botës pas triumfit në Nju-Jork. Dedikimi shkon për tezen nga Tiroli i Jugut: "Ajo nuk është shumë mirë me shëndet. Nuk e di edhe sa do të qëndrojë pranë meje. Është shumë bukur që mund të ndaj momente pozitive me të. Ajo është shumë person i rëndësishëm në jetën time".

#### PSG - Enrique, pritet vazhdimi i bashkëpunimit

PSG - Luis Enrique nuk ishte një dashuri me shikim të parë, por palët tani duken shumë të lumtur në këtë marrëdhënie, aq sa janë gati të shkojnë drejt një rinovimi. Sipas medieve, sheiku Al Khelaifi i ka ofruar teknikut spanjoll rinovimin e kontratës, aktualja përfundon më 2025. Puna e bërë nga Enrique është vlerësuar shumë, menaxhoi shumë mirë çështjen "Mbappe", fitoi titullin në Francë, ndërsa edhe këtë sezon ekipi po funksionin në perfeksion. Sipas gazetarit Fabrizio Romano, edhe Luis Enrique ka shprehur dëshirën e tij për të qëndruar në Paris duke bërë që palët ta gjejnë gjuhën e përbashkët për rinovimin e kontratës.

#### Pogba planifikon rikthimin në fushë pas dënimit për doping

Fundi i sezonit të kaluar ishte dërmues për Paul Pogban, ish-mesfushorin francez të Juventusit që u pezullua me katër vjet nga agjencia antidoping, pasi u gjet me një substancë të ndaluar në analizat rutinë në Serinë A. Tanimë mesfushori ka apeluar vendimin dhe do të jetë CAS në Lozanë që do të vendosë pikat mbi "i", si e vetmja shkallë që mund të ndryshojë këtë vendim, kjo në bazë të provave të reja sipas apelimit. Vendimi nga CAS i Lozanës për rastin Pogba pritet në javët në vijim. Siç raporton "La Gazzetta dello Sport", ditët e fundit futbollisti ka shkruar në gjykatë për të dhënë një dëshmi sekrete. Nëse ankesa pranohet, ka mundësi që Pogba të kthehet në fushë. Në fakt, ai mund të kthehet për të luajtur në Arabinë Saudite me sheikët të gatshëm për t'i ofruar një kontratë. Kujtojmë se pas pezullimit nga organet e dopingut, Juventus ndërpreu kontratën me Pogban.

## Maresca: Jam shumë i lumtur që e kemi Sanchon

Chelsea befasoi të gjithë kur në ditën e fundit të afatit kalimtar të verës transferoi sulmuesin anësor Jadon Sancho. Në fakt Sancho është bashkuar me londinezët si

huazim nga Manchester Unitedi, por që Chelsea e ka blerjen e obligueshme në fund të sezonit. Trajneri Enzo Maresca shpjegoi saktësisht se si Sancho do ta

përmirësojë skuadrën e tij. "Jam shumë i lumtur që kam Sanchon në Chelsea, ai është këtu sepse ne e pëlqejmë atë lloj lojtari që mund ta ndihmojë skuadrën sidomos në

lojën një kundër një që është i jashtëzakonshëm. Ai është çelësi, veçanërisht kundër një blloku të ulët, ne kemi nevojë për të. Vërtet jam shumë i lumtur që e kam në

skuadër", ka thënë Maresca. Sancho ende nuk ka debutuar me Chelsea, derisa një gjë të tillë pritet ta bëjë në fundjavë në sfidën ndaj Bournemouthit.





Nr.prot.: 2638/24, Datë: 06.09.2024

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues (KD), numër 319/16, të datës 06.06.2016, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), me datë 06.09.2024, shpallë:

### OFERTË PËR LËSHIMIN E HAPËSIRAVE ME QIRA PËR BUFE

Kushtet dhe kriteret për lëshimin e hapësirave me qira për bufe:

- Hapësirat, të cilat janë ofertuar për qiradhënie, gjenden në katin përdhësë të objektit të UShAF, me një sipërfaqe prej 283.50 metër katrorë (m<sup>2</sup>) (kuzhina 28.50 m<sup>2</sup>, banaku 18.00 m<sup>2</sup>, bufe 110.50 m<sup>2</sup> dhe terasa e bufesë 126.50 m<sup>2</sup>);
- Qiramarrësi do ta ketë të drejtën që në hapësirat e marra me qira të bëjë përmirësime, meremetime dhe adaptime shtesë (duke mos rrezikuar për asnjë moment konstruksionin dhe stabilitetin e objektit), investime të cilat do të mbulojnë nga vet qiramarrësi;
- Qiramarrësi do të ketë në dispozicion të gjitha pajisjet të cilat ndodhen në hapësirat që jepen me qira (inventar dhe kuzhinë);
- Qiramarrësi duhet të kompletojë sipas standardeve kuzhinën dhe inventarin me pajisje të cilat mungojnë;
- Qiradhënësi do të paguaj të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës, ujit, pastrimit, ngrohjes dhe sigurimit.

Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim:

Operatorët ekonomik të cilët marrin pjesë duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin;
- Numrin fiskal të biznesit;
- Të kenë aktivitet të hotelierisë apo gastronomisë;
- Të mos të ketë obligime paraprake ndaj Administratës Tatimore (Dëshmi që duhet të mirret nga ATK);
- Të kenë dëshmi që janë të gatshëm për shërbime në sektorin e gastronomisë (fotografi, video dhe meny të ushqimit dhe pijeve që planifikohen të shërbehen);
- Të ofrojnë çmimoren e produkteve bazë që do shërbehen (çmimi i produkteve brenda bufes duhet të jetë më i ulët se sa çmimet standarde që janë në sektorin e jashtëm);
- Operatori ekonomik i cili është lider, duhet të plotësojë 100% të kriterëve dhe dokumenteve të kërkuara.

Kohëzgjatja e ofertës për shprehje të interesit dhe mënyra e aplikimit:

- Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur.
- Ofertat duhet të dorëzohen në Administratën e UShAF-it, zyra numër 008.
- Ofertat e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, nuk do të merren në shqyrtim.
- Kohëzgjatja për shpalljen e ofertës është e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të kësaj oferte, përkatësisht nga data 09.09.2024 deri më 23.09.2024.
- Të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë që paraprakisht t'i vizitojnë hapësirat në UShAF dhe t'i verifikojnë sipërfaqet e hapësirave, me datën 19.09.2024 nga ora 10:00 deri në ora 12:00.
- Ofertat dorëzohen në një zarf, në të cilin shkruhet "Ofertë për lëshimin e hapësirave me qira për bufe", brenda të cilit janë dy zarfe të tjera. Në njërin zarf vendoset i tërë dokumentacioni dhe materiali i kërkuar, ndërsa në zarfin tjetër vendoset vetëm çmimi i ofruar për metër katrorë (m<sup>2</sup>).
- Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur me datë 23.09.2024 nga ora 14:00 deri në ora 15:00.

Përzgjedhja e qiramarrësit:

- Qiramarrës do të përzgjidhet ofertuesi që plotëson kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar dhe ofron vlerën më të madhe të pagesës për metër katrorë (m<sup>2</sup>).

Kohëzgjatja e kontratës me qiramarrësin:

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 10 vite.

E drejta e ankesës:

- Ankesa bëhet më së largu shtatë (7) ditë nga dita e përzgjedhjes së ofertuesit;
- Ankesa dorëzohet në UShAF, në zyren numër 008.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

### NJOFTIM PËR VAZHDIM TË AFATIT TË KONKURSIT

KRM "Pastrimi" më datën 24.08.2024 ka hapur konkursin për pozitën Shef i Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv dhe është mbyllur në datën 07.09.2024.

KRM "Pastrimi" vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Shef i Kabinetit të Kryeshefit Ekzekutiv deri më datën 13.09.2024.

### OBAVEŠTENJE O PRODUŽENJU KONKURSNOG ROKA

KRM „Pastrimi“ je 24.08.2024. godine otvorio konkurs za poziciju šefa Kabineta glavnog izvršnog direktora i isti je zatvoren 07.09.2024.

KRM „Pastrimi“ nastavlja rok za raspisivanje javnog konkursa za funkciju šefa Kabineta glavnog izvršnog direktora do 13.09.2024.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatlume Shala shpall te pavlefshme dëftesën dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Hyrije Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - LV shfmu "Dëshmorët e Vrrinit" Billushë.

- Elez Krasniqi shpall te pavlefshme certifikatën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Eldar Skenderi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Gani Saramati" Prizren.

- Pranvera Hoti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës SHMU "Asllan Berisha", Rogovë, komuna e Gjakovës nga klasa e 6-9.

- Bleard Maxhuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SHMU "Ahmet Rustemi", Bec komuna e Gjakovës, nga klasa e 6-9.

- Gerti Murtezaja nga Beci i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e SHMU "Ahmet Rustemi", Bec komuna e Gjakovës, nga klasa e 6-9.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)




**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 10.09.2024 të rishpall:

**KONKURS**

**Një (1) Vozitës i kategorisë "C"**- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 428.56 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Sipas Urdhresës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësinë, higjienën dhe pastërtinë të tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhresës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhresën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letren e re të tabograftit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letren e tabograftit ka obligim që në të shënohen: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjeket e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhresën e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Cdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtëpërdrejt;
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave ta përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjetet me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhresës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrje;

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtuar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtë të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacioni i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjekësore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtë në gazeta ditore, dhe atë nga data 10.09.2024 deri me 24.09.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj" p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.


**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 10.09.2024 të shpall:

**KONKURS**

**Një (1) Punëtor Fizik**- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14

Përgatitja profesionale: Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme

Lartësia e pagës mujore: 382.36 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjërë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejt.

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtuar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtë të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacioni i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjekësore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtë në gazeta ditore, dhe atë nga data 10.09.2024 deri me 24.09.2024, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj" p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazit" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, [www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com), [info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **17.07.2024**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

**SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STUDENTAVE PËR VITIN AKADEMIK 2024/2025**

**01.07.2024 deri më 30.09.2024**

| <b><u>STUDIME BACHELOR</u></b>   | <b><u>STUDIME MASTER</u></b>   |
|--|--|
| <b>1.BANKA DHE FINANCA NË BIZNES (BA) - (3 vjeçar)</b><br><b>2.MENAXHMENT DHE EKONOMIKS (BA) - (3 vjeçar)</b><br><b>3. SHKENCA KOMPJUTERIKE (BA)- (3 vjeçar)</b> | <b>1.MENAXHMENT DHE FINANCA – MA-(2 vjeçar)</b><br><b>2. MENAXHIMI I EMERGJENCAVE -MA-(2 vjeçar)</b> |

| Dokumentat e nevojshme për Aplikim BACHELOR  | Dokumentat e nevojshme për Aplikim MASTER  |
|--|--|
| Diplomën e shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)<br>Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme, (Original ose të noterizuar)<br>Dëftesat e viteve (klasave) - I, II, III, / X, XI, XII (Original ose të noterizuar)<br>Certifikatën e lindjes,<br>Kopja e letërnjoftimit,<br>Dy foto. | Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)<br>CV<br>Certifikatën e lindjes<br>Kopjen e letërnjoftimit<br>Dy foto |

[www.kolegjobiznesi.com](http://www.kolegjobiznesi.com),  
[info@kolegjobiznesi.com](mailto:info@kolegjobiznesi.com)

**038/045/044- 500 878**  
**049/ 048- 500 – 878**  
**029-230-555 : 044 131027**





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909  
0.5L





# TRADITË QË NGA 1992

